



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën 25.06.2019 ne Lipjan ndërmjet:

- Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan
z. Adem Duriqi në njërën anë (në tekstin e mëtejme) Autoriteti Kontraktues dhe

Emri i Kontraktuesit Operatori ekonomik "Eor Group" Shpk nga Prishtina të cilin e përfaqëson
Shpresa Veliu drejtor në vazhdim përdoret (shkurtesa) Kontraktuesi

Titulli i Kontratës: "Furnizimi me pajisje të zërimit për Qerdhen në Lipjan"

Nr referues i kontratës 613 019 76 136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është: Audio mikseta e amplifikuese, Zmadhuesit e zërit, Shtylla për zmadhues, Audio kabell Konektor për zmadhues, Mikrofon statik, Kabell mikrofonik, Mikrofon statik dhe Shtyllë e mikrofonit të gjitha të specifikuara të përshkrimi i çmimeve.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me vënien e nënshkrimit nga të dy palët ,gjegjësisht me 25.06.2019 dhe përfundon 5 ditë nga dhënia e urdhërblërjes.

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga dhënia e urdhërblërjes.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve është Qerdhja e fëmijëve në Lipjan

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata Komunale Lipjan.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm i kontratës shprehur në shifra është 2,895.00€ me fjalë dymijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë /euro/ e zero /cent/

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës nëse fatura e ka të bashkangjitur raportin e menaxherit të kontratës se shërbimet janë kryer me cilësi dhe në afat sipas planit dinamik të paraparë në kontratë. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara te përshkrimi i çmimeve.

Neni 7 Garancioni

7.1 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në material. Kontraktuesi do të garantojë se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet në materialet dhe kryejnë funksionin pa pengesa

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,5% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë paisjet e zërimit që janë përgatitur për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse paisjet kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Menaxher të kontratës është Biha Azemi nr tel 044 206 965

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.


13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën komunale në Lipjan në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14**Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në 4 origjinale, 3 origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues**Për Operatorin Ekonomik**

Emri:	Daut Reçica	Emri:	Shpresa Veliu
Pozita:	U.D. i drejtorit të prokurimit	Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.06.2019	Data:	26.06.2019
Vula:		Vula:	

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr.	Modeli	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Audio mikseta e amplifikueme	Mikser intuitive me 10 kanale hyrëse (6 Mic / Line + 4 Mic / Stereo-Line) Përforcues shumë i fuqishëm dhe i besueshëm me 2 x 1.000 Watts / 4 Ohms 2 Efektet me cilësi të lartë të redaktimit, 100 fabrika dhe 20 parazgjedhje të përdoruesve Interfoni USB me 24-bit / 96 kHz 4x4 me MIDI Paketë me peshë të lehtë (14 kg) me mbulesë shtesë të fuqishme Kanalet (Mono + Stereo) 6 + 4 Auxiliaries (MON, FX, AUX) 2 Pre, 2 Post, 2 Pre / Post kalueshme Max. Fuqia dalëse e një kanali, Dynamic-Headroom, IHF-A në 2.66 Ω 2 x 1600 W në 4 Ω 2 x 1250 W në 8 Ω 2 x 675 W Max. Fuqia dalëse e një kanali, i vazhdueshëm, 1 kHz, THD = 1% në 2.66 Ω 2 x 1350 W në 4 Ω 2 x 1150 W në 8 Ω 2 x 650 W Fuqia maksimale e daljes në mes, 1 kHz, THD = 1%, Kanali i dyfishtë në 2.66 Ω 2 x 1350 W në 4 Ω 2 x 1000 W në 8 Ω 2 x 600 W Fuqia dalëse e vlerësuar, 20 Hz deri në 20 kHz, THD <0.5%, Kanali i vetëm në 4 Ω 2 x 900 W në 8 Ω 2 x 450 W Tensioni maksimal i daljes, i amplifikatorit të fuqisë, 1 kHz, pa ngarkesë 74 Vrms THD, në 1 kHz, MBW = 80 kHz mm Me kapak: Përmasat (L x H x D), 510,5 x 164,5 x 571,5	Copë	1	1300.00	1300.00

		Raft-mali: 483,0 x 135,0 x 443,7 peshë Pesha neto, pa kapak 12,5 kg Pesha neto, me kapak 14 kg Pesha e transportimit 17 kg				
2	Zmadheuset e Zerit	• Vlerësimi i fuqisë: 400 W RMS, kulmi 1600 W • Pajisur me 15 "woofer / 1.5" shofer compression • Frekuenca e frekuencës: 50 - 20,000 Hz • SPL: 134 dB max. • Impedanca: 8 ohm • Modeli i shpërndarjes: 90 ° x 50 ° • Shtojca e trekëndëshit / flanxheve të qëndrimit • Përmasat: 708 x 432 x 382 mm • Pesha: 23 kg • Driver DH-1K 39mm (1.5 ") Titanium Diaphragm Compression Driver • • EVS-15K 381mm (15 ") Woofer • Frekuenca 50 Hz - 20 kHz • • 95 dB ndjeshmëri SPL; 134 dB max SPL • 400 W i vazhdueshëm dhe 1600 W i fuqisë kulmore • • Mbërthen e poleve ose stacks me Subwoofers Live X • • Drejtimi i valës me frekuencë të lartë me modelin e mbulimit 90 ° x 50 ° • • 60 ° Angle Monitorimi • • Shtojcë me kompensatë 15mm, i ndërprerë brenda, me bojë të ngjyrosur	Copë	2	430.00	860.00
3	Shtylla per Zmadhues	• Materiali: alumini • Sipërfaqja: powder-veshura • Ngjyra: e zezë • Ndërtim: X qëndrim • Ngjyra e tubave: e zezë • Sipërfaqja e tubave: me pluhur të veshur • Min. lartësia: 1060 mm • Maks. lartësja: 1920 mm	Copë	2	30.00	60.00

		• Gjatësia e transportit: 1050 mm • Lartësia e rregullueshme: po • Lloji i rregullimit të lartësisë: Shtrengoni me kunjën e sigurisë • Materiali i rregullimit të lartësisë: çeliku • Lloji i bazës: Leg për bashkë • Materiali bazë: alumini i derdhur • Diametri i tubit: 35 mm • Maks. ngarkesa: 50 kg • Unaza e zezë e vendosur përfshinte: po • Unaza të ndërrueshme: 5 x 30 mm				
4	Audio Kabellell	• AUDIO KABELL PER NDERLIDHJE TE ZMADHESVE • 2 x 2,5 mm seksioni terthor	Metër	30	2.00	60.00
5	Konektor per zmadhues	KONEKTOR PER ZMADHUES	Copë	4	5.00	20.00
6	Mikrofon statik	• Karakteristikë kardioid • Përgjigjja e frekuencës optimizuar për vokal me mids të ndriçuar dhe rreshtin e basit • Karakteristika kardioide izolon burimin kryesor të zërit dhe zvogëlon zhurmën e sfondit • Sistemi i montuar i montimit pneumatik minimizon zhurmën e trajtimit • Era dhe filtri i integruar efektiv i erës • Përgjigjja e frekuencës: 50 - 15,000 Hz • Impedancë e daljes: 300 Ohm • Ndjeshmëria: -54.5 dBV / Pa (1.88 mV) • SPL: 94 dB • Dimensionet: 23 x 162 x 51 mm • Pesha: 298 g • incl. qese ruajtëse mikrofonit, clip mikrofon dhe përshtatës filetues 3/8 "	Copë	1	130.00	130.00

7	Kabell Mikrofonik	Audio kabell per nderlidhje te mikrofonit me mikset	Copë	5	15.00	75.00
8	Mikrofon statik	Kardioid Polar Modeli Përfshin përshtatësin e rrymës Përfshin xhepin e zinxhirëve me vinç Ndërprerësi ndezur / fikur 15 'XLR në kablllo XLR Përgjigja e frekuencës 50 deri në 15,000 Hz Impedance 600 Ohm Lidhja Output -52 dBV / Pa * në 1kHz * 1 Pa = 94 dB SPL Lidhja e daljes XLR-¼ "(6.3 mm)	Copë	4	60.00	240.00
9	Shtylle e Mikrofonit.	• Këmbët e palosshme me bazën vdesin-hedhur • 3/8 "Thread në clip mikrofon • Gjatësia është e rregullueshme nga 105 në 170 cm • Banda e bumit: 75 cm • Ngjyra: E zezë	Copë	5	30.00	150.00
						2,895.00